



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

DHJETOR, 2024

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin dhjetor 2024 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), të cilat krahasohen nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara dhe në disa raste edhe rastet e dyshuara dhe të konfirmuara.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit dhjetor 2024 zënë 27.8 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 213.6/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 4.1/100.000 banorë. NJVKSH Berat dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive për diagnozën e saktë klinike dhe konfirmimin e saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin dhjetor 2024 në nivel kombëtar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin dhjetor 2024 (Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste dhjetor 2024	Incidenca dhjetor 2024 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.0
Salmoneloza	5	0.17
Shigelozë (Disenteri bacilare)	2	0.07
Dizenteri amebike	0	0.0
Toksiko-infeksione alimentare	130	4.5
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	5978	208.8
Sëmundje diarreike në total	6115	213.6

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit dhjetor 2024 janë raportuar në total 325 raste variçelë (incidenca 11.3/ 100.000 banorë) nga të cilat, 216 raste janë të dyshuara dhe 109 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen variçelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 104 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 135 raste, grafiku 1.


Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës, dhjetor 2024



2.2 Fruthi

Gjatë muajit dhjetor është raportuar një rast me fruth i cili u konfirmua nga ana laboratorike si pozitiv me virusin e fruthit.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara me fruth dhe incidenca sipas muajve 2024




Rasti i përket moshës 27 vjeç, gjinisë femër, banore e bashkisë Tiranë. Pacientja ka shfaqur shenja klinike të fruthit dhe është ndjekur në rrugë ambulatorë. Nga ana e shërbimit epidemiologjik është kryer hetimi në vatër për rastin, dhe janë marrë masat e kontrollit për ndërprerjen e transmetimit të virusit.

3. Hepatitet virale

Hepatit viral B (HBV)

Në muajin dhjetor janë raportuar 5 raste të konfirmuar me HBV. Incidenca e HBV-së në muajin korrik është 0.2 raste/100 000 banorë në vend.

Grafiku 3. Numri i rasteve të reja me HBV dhe incidenca (raste/100 000 banorë) sipas muajve




Rastet në muajin dhjetor i përkasin grup-moshës adulte nga 33-48 vjeç, 4 raste (80%) të gjinisë femër dhe 1 rast i përket gjinisë mashkull (20%). Rastet janë banorë nga bashkia Dibër (3) dhe Lushnjë (2), dhe kanë shfaqur shenja klinike të HBV-së.

Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin dhjetor është raportuar 1 rast i konfirmuar me HCV. Rasti i përket bashkisë Durrës, i moshës 69 vjeç, gjinia femër, dhe ka shfaqur shenja klinike të HCV-së.


Grafiku 4. Numri i rasteve të reja me HCV dhe incidenca (raste/100 000 banorë) sipas muajve



4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS

Gjatë muajit dhjetor 2024 janë kryer 32 ekzaminime për HIV (19 meshkuj dhe 13 femra) prej të cilave 5 raste (3 femra dhe 2 meshkuj) kanë rezultuar HIV pozitiv, grafiku 5.

Grafiku 5. Shpërndarja e testimeve dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitiv është në Tiranë - 2 raste, Elbasan - 2 raste dhe në Durrës 1 rast.

Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 1 rast i përket grup-moshës 16-24 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 24-34 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 35-44 vjeç dhe 2 raste i përkasin grup-moshës 45-54 vjeç.

Rastet e konfirmuara kanë ardhur: 2 raste nga QSUT, 2 raste vijnë nga si vullnetarë pranë NJVKSH –Elbasan dhe 1 rast është nga ndjekja epidemiologjike e një rasti HIV pozitiv.

Gjatë muajit dhjetor 2024 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 4 raste të konfirmuara me Sifiliz. Incidencë e kësaj sëmundjeje për muajin dhjetor 2024 është 0.14 raste / 100000 banorë.

5. **Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar**

Gjatë muajit dhjetor 2024 janë raportuar gjithsej 16 raste me turbekuloz (TB). Prej të cilave 4 raste janë pulmonare dhe 2 raste ekstrapulmonare.

Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv.

Rastet pulmonare përkatësisht janë: 2 në Tiranë, 1 në Fier, dhe 1 në Bulqizë.

Raste recidive per muajin dhjetor ka vetëm 1 në Tiranë.

Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e bashkisë përkatëse. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse, të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB janë të fokusuara kryesisht në Tiranë me numër më të madh.

6. **Sëmundjet zoonotike**

Tabela 2: Shpërndarja e zoonozave në muajin dhjetor 2024, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikeciozë)

	Dhjetor (raste 2024)	Incidenca (raste/100,000) 2024
Antraks (Plasje)	1	0
Brucelozë	2	0.07
Leptospirozë	1	0.03


Për muajin dhjetor janë raportuar 2 raste Bruceloze përkatësisht: 1 në Has dhe 1 në Gjirokastrë. Gjithashtu është raportuar 1 rast i konfirmuar me Leptospirozë nga Shkodra dhe 1 rast me Antraks nga Gjirokastra.

7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19

Gjatë muajit dhjetor 2024 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 8 raste të konfirmuara me COVID-19, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin dhjetor është 0.28 raste /100000 banorë.

Grafiku 6. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është grup-mosha 75+ vjeç dhe 35-44 vjeç me incidencë 0.6 raste për 100000 banorë, e ndjekur nga grup-mosha 45-54 vjeç me incidencë 0.55 raste për 100000 banorë.


Rastet janë raportuar nga bashkitë Himarë, Pukë, Sarandë dhe Vlorë me 1 rast për secilën dhe 4 raste në Tiranë.

Gjatë muajit dhjetor 2024 janë raportuar 3 raste të shtruara në spital dhe asnjë rast vdekje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 62.5% (5 raste) në ISHP dhe 37.5% (3 raste) janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve.

7.2 Grip

Gjatë muajit dhjetor janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 47 raste të konfirmuara me grip, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin dhjetor është 1.64 raste /100000 banorë. Grafiku 7 tregon shpërndarjen e rasteve sipas tipit të viruseve qarkullues. Vërehet mbizotërim i gripit Tipi A.

Grafiku 7. Tipi i viruseve qarkulluese



Në muajin dhjetor qarkullimi i gripit arriti intensitet mesatar duke paraqitur aktivitet sezonal normal të zakonshëm dhe të pritshëm për stinën, dhe përhapje gjeografike rajonale. Raste me grip u identifikuan si nga survejanca sentinel ILI-SARI, ashtu edhe nga survejanca virologjike josentinel.

8. Sëmundje të tjera

8.1 Meningit bakterial meningoskoksik

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit dhjetor 2024 nga Spitali Infektiv Tiranë, është raportuar 1 rast i konfirmuar me meningit bakterial specifikisht *Neisseria meningokoksik*.

Rasti është i grup-moshës 15-19 vjeç, gjinia femër nga Durrësi. Rasti ka paraqitur shenja klinike të meningitit dhe ka bërë exitus në spitalin infektiv pranë QSUT-së. Rasti është konfirmuar me *Neisseria meningitidis* në laboratorin mikrobiologjik të QSUT-së dhe ISHP. Shërbimi i epidemiologjisë dhe i shëndetit mjedisor pranë NJVKSH Durrës ka bërë hetimin në vatër, dhe ka marrë masat përkatëse.

Gjatë hetimit nuk është konstatuar asnjë rast tjetër i dyshuar. U depistuan 284 nxënës të shkollës ku ishte pacientja, dhe 83 prej tyre filluan profilaksinë duke u bazuar në kriteret e protokollit të parandalimit.

8.2 Leshmanioza Viscerale

Gjatë muajit dhjetor 2024 është raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 1 rast i konfirmuar me *Leishmania cutanea*. Rasti është i grup-moshës 5-14 vjeç, nga bashkia Kukës.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK

DEKSI